



KUVENDI KOMUNAL PRISHTINE * MUNICIPALIT ASSEMBLY PRISHTINA * SKUPSTINA OPSTINA PRISTINA

Në bazë të nenit 40, al. 2, të Ligjit mbi tokën ndërtimore ("Gazeta zyrtare e Kosovës" nr. 14/80), dhe nenit 9 mbi ndryshimet dhe plotësimet e e Ligjit mbi tokën ndërtimore ("Gazeta zyrtare e Kosovës" nr. 42/86), nenit 3 të Rregullorës mbi vetëqeverisjen e komunave të Kosovës nr. 2000/45, të dt. 11 gusht 2000 dhe nenit 19 të Statutit dhe rregullave të procedurës të Komunës së Prishtinës, të dt. 16.03.2001, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më dt. 30.01.2004, merr

V E N D I M

PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR NDËRTIMIN E OBJEKTIT FETAR-XHAMISË NË FSHATIN BARDHOSH KK PRISHTINË

Neni 1

Miratohet Vendimi për caktimin e lokacionit për ndërtimin objektit fetar-Xhamisë në fshatin Bardhosh KK Prishtinë.

Neni 2

Lokacioni për ndërtimin e objektit, sipas këtij Vendimi, përfshinë pjesën e ngastrës kadastrale nr. 495/1 Komuna Kadastrale Bardhosh, në sipërfaqe prej 8.5 ari, pronë e Komunës së Prishtinës.

Lokacioni, nga alinea 1 e këtij neni, i jepet në shfrytëzim Bashkësisë Islame të Kosovës.

Neni 3

Destinimi i caktuar i lokacionit, sipas këtij Vendimi, do të inkorporohet në Planin e ardhëshëm zhvillimor të Komunës së Prishtinës.

Neni 4

Ky Vendim paraqetë bazë për caktimin e kushteve urbanistike-teknike për rregullimin e hapësirës së lokacionit, nga neni 2 i këtij Vendimi.

Neni 5

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Bordi i drejtorëve i Komunës së Prishtinës.

Drejtorati i Planifikimit, Urbanizmit dhe Ndërtimtarisë, Drejtorati për Kadastër dhe Gjeodezi i Komunës së Prishtinës, do të kryejn veprime nga përgjegjësia e tyre, e caktuar për realizimin e këtij Vendimi.

Neni 6

Ky Vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS

01.NR. 351-254 DT. 09.02.2004

KRYETARI I KUVENDIT
Ismet Beqiri